

Letërnjoftimi i Komunës së

GJAKOVËS

2014

Maj, 2015



Fakte


- Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Gjakovës kanë qenë afro 2,8 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.
- Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 45,3% të të hyrave të përgjithshme.
- Në administratë komunale janë të punësuar 332 persona, apo një shërbyes civil për 289,6 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Gjakova ka edhe së paku 8 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudha disa mujore.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,573 persona, prej tyre 1,278 mësimdhënës. Në Komunën e Gjakovës raporti nxënës/mësimdhënës është 33,9. Mesatarja në shkallë vendi është 29,9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 353 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Gjakovës është 272,4. Mesatarja në shkallë vendi është 282,7.
- Gjakova gjatë vitit 2014 ka pasur 4,692 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Gjakovë rreth 4,8% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Gjakovës funksionojnë 6,427 biznese. 362 biznese janë biznese prodhuese.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 451 biznese të reja.
- Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara në 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare apo 189 sosh, 52 biznese të industrisë përpunuese, 41 agjenci shërbyese, 39 biznese transportuese, etj.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 135 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e ndërtimit.
- Kryetarja e Gjakovës Mimoza Kusari-Lila gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 32 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 31%, apo mbi mesatarën në shkallë vendi, e cila është 24%.

2 Qeverisja komunale

Komuna e Gjakovës në zgjedhjet e fundit lokale (2013) ka kaluar nga Aleanca e Ardhmërisë së Kosovës (AAK) në qeverisjen e Aleanca Kosova e Re (AKR). Kryetarja aktuale e Gjakovës znj. Mimoza Kusari-Lila ka fituar mandatin pas balotazhit, i zhvilluar mes saj dhe ish Kryetarit nga radhët e AAK-së z.Pal Lekaj.

Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 45,447 apo rreth 43,2% qytetarë me të drejtë vote. Në balotazhin e mbajtur më 1 dhjetor 2013, Mimoza Kusari-Lila ka marr 52,3%, ndërsa Pal Lekaj ka fituar 47,6% të votave.


Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë dhe në balotazh



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: AKR 9 ulëse, AAK-LDD 9 ulëse, PDK me gjashtë ulëse ,LDK katër ulëse, ndërsa VV dy ulëse, ndërsa DP dhe PDKI i kanë siguruar me nga një ulëse.

Ekzekutivi komunal i Gjakovës ka 12 drejtori komunale. Pas zgjedhjeve, Kryetarja Mimoza Kusari-Lila ka arritur marrëveshje me LDK për bashkëqeverisjen e komunës.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Gjakovës në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Gjakovës


Më 2014, Komuna e Gjakovës kishte buxhet prej 19,4 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje. Buxheti për investime kapitale është 5 milion euro, një rënie për 1 milion në krahasim me një vit më herët.

Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Gjakovës dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Gjakovës kanë qenë afro 2,8 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.

Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Gjakovës 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave janë nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë afro 45,3% të të hyrave të përgjithshme apo 1,3 milion euro në vitin 2014.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitet tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Gjakovës ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Mitrovica, Suhareka, Lipjani, Podujeva, etj., ndërsa më pak se sa Gjilani, Peja, Ferizaji etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë, ndërsa shpenzimet për telefoni fikse janë rritë për 9 mij euro më shumë duke e krahasuar me një vitë më herët, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për energji elektrike rreth 461 mijë euro, apo 61 mijë euro më shumë krahasuar me një vit më herët. Shpenzimet për mbeturina janë për 30 mijë euro më shumë se një vitë më herët, ashtu edhe siç mund të shihet në figurën nr.8


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Gjakova e ka përmbyllur me 2,258 të punësuar në sektorin publik. Numri i të punësuarve në sektorin publik nuk ka pas rritje, përveç në sektorin e arsimit ka një rritje e lehtë tek numri i ri i të punësuarve, sa i përket administratës dhe shëndetësisë ka një numër më të vogël të punëtorëve se sa një vit më herët.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Gjakovës




Gjakova ka të punësuar një shërbyes civil për 289 banorë. Në krahasim me komnat tjera, Gjakova qëndrom afër mesatarës në nivel të vendit, mesatarja në nivel vendit është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Gjakova ka edhe së paku 8 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudhë disa mujore.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,573 persona, prej tyre 1,278 mësimdhënës. Në Komunën e Gjakovës raporti nxënës/mësimdhënës është 33,9. Mesatarja në shkallë vendi 29,9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Gjakovës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 353 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Gjakovës është 272,4. Mesatarja në shkallë vendi është 282,7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Në Komunën e Gjakovës funksionojnë 6,427 me veprimari të ndyshme biznesi. 362 biznese janë prodhuese. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 451 biznese të reja, një numër më i madh se sa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara në 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 135 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e ndërtimit. Krahasuar me një vitë më herët numri i bizneseve të shuara është rritur dukshëm.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga znj.Mimoza Kusari-Lila gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 32 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 znj.Kusari-Lila ka arritur të realizoj 31% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

